



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPSTINA VUCITRN

PROCESVERBAL

nga mbledhja e IX-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më
13 nëntor 2020 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 14:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Nasuf Aliu (kryesues), Gresa Muli, Ymer Haradinaj, Shkëlzen Feka, Arta Ymeri, Nezir Klinaku dhe Teuta Aruçi Shartari (anëtarë të KPF -së).

Munguan: Shpëtim Zhegrova dhe Melihate Basholli-Latifi.

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Xhafer Tahiri (kryetar i Komunës), Besim Muzaqi (nënkryetar i Komunës), drejtorët e drejtorive (Refik Maloku, Adnan Lahu, Berat Sadiku, Miran Halili, Agron Përçuku dhe Mehmet Selaci), si dhe nga sekretaria e kuvendit: Batri Duraku dhe Bujar Klinaku.

Kryesuesi i kuvendit dhe i KPF-së, Nasuf Aliu takimin e filloi me një minutë heshtje në shenjë respekti dhe nderimi me rastin e vdekjes së anëtarit të kuvendit të komunës, Safet Idrizi dhe zyrtarit komunal, Emin Ibishi.

Në emër të KPF-së, Aliu i uroi shërim të shpejtë edhe anëtares së kuvendit dhe KPF-së, Melihate Bashollit – Latifit.

Ai konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë. Aliu theksoi se kanë ardhur edhe disa pika për t'i futur në rend të ditës. Lidhur me këtë, ai kërkoi edhe nga kryetari i komunës që në mbledhjen e bordit të diskutojë me drejtorët e drejtorive që të mos i vonojnë materialet për procedim në KPF dhe kuvend, por të respektohet afati ligjor.

Aliu theksoi se këto janë pikat që kanë ardhur për t'u futur në rend të ditës:

- Shqyrtimi i Draft - Strategjisë Zhvillimore e Komunës për 2020 - 2025;
- Shqyrtimi i Draft - Strategjisë së përkrahjes së prodhuesve në Komunën e Vushtrrisë;
- Shqyrtimi i Propozim vendimit për formim të komisionit vlerësues për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;
- Shqyrtimi i konkursit publik për vendosje të bizneseve në Parkun Industrial.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës – theksoi se duhet ta kemi parasysh që është kohë pandemie dhe se disa zyrtarë janë të infektuar me covid 19, prandaj për këtë arsye po ka vonesa. Edhe pse disa herë kam kërkuar nga drejtorët e drejtorive që të jenë më azhur, tha ai.

Ai i njoftoi të pranishmit që të kenë mirëkuptim, sepse në mbledhjen e kuvendit të komunës mund të vjen si pikë e rendit të ditës: Propozim – vendimi për caktimin e lokacionit të Ndërmarrjes Publike Lokale “Përparimi” Sh.a. në Vushtrri, ku sot është themeluar me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – deklaroi se jemi pajtuar në KPF që nuk do t'i pranojmë pikat shtesë që vijnë pas afatit ligjor, vetëm nëse ndonjëra prej tyre është urgjente. Nëse nuk janë të natyrës urgjente, nuk kemi nevojë t'i fusim në rend të ditës, tha ai.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës – tha se thirrja për zonën ekonomike në Lumadh është dashur të bëhet më herët. Nëse nuk bëhet tani, kur të hyjmë në gjashtëmujorin e fundit para skadimit të mandatit nuk mund të bëhet fare. Pasi që investimet janë në përfundim, duhet ta bëjmë thirrjen në mënyrë që të kryhen procedurat dhe që askush mos të thotë se u përdor për qëllim të fushatës zgjedhore.

Ndërkaq, lidhur me strategjitë për shkak të pandemisë, mezi kemi arritur që ta mbajmë një workshop. Kurse, konkursi për drejtor dhe zv/drejtor është vonuar. Prandaj, ju ftoj që t'i përkrahni këto pika shtesë që t'i dërgojmë në kuvend

Adnan Lahu, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – deklaroi se me ndryshimin e ligjit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, obligohemi që deri në fund të vitit, komuna ta ketë të publikuar listën e pronave që mendon t'i japë në shfrytëzim.

Gresa Muli, anëtare e KPF-së – kërkoi që pika tetë (8): “Shqyrtimi i Propozim – vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Sheshit të Pavarësisë “Ibrahim Rugova” ,të hiqet nga rendi i ditës. Kjo për arsye se, në këtë propozim –vendim flitet për caktim të lokacioni, por kuvendi i komunës më datë 31 janar 2019 ka marrë një vendim për parcelën në fjalë, kurse në 28 shkurt 2019 është bërë plotësim –ndryshimi i atij vendimi, ku u vendos që ajo pronë të jepet për 40 vite. Kuvendi i komunës e obligoi komisionin që t'i ndjek procedurat për shpalljen e konkursit publik, ku pjesë e këtij komisioni kam qenë edhe unë dhe çuditërisht asnjëherë nuk jam ftuar nga kryesuesi i këtij komisioni për zhvillimin e procedurave.

Prandaj, konsideroj që është e kundërligjshme të merret një vendim tjetër, pa u zhvilluar procedurat e vendimit paraprak.

Muli theksoi se këto janë arsyet që kërkoj të hiqet nga rendi i ditës dhe komisioni në fjalë të filloj punën e tij me zhvillimin e procedurave ashtu siç parashihet me ligj.

Adnan Lahu, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – deklaroi se me ndryshimin e ligjit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës kanë ndryshuar edhe procedurat, ku kërkohet që për secilën parcelë për dhënie në shfrytëzim duhet të formohet komision të ri. Përderisa, ajo pronë nuk është dhënë në shfrytëzim, nuk shoh ndonjë arsye që të mos anulohet apo mos të anulohet ai vendim.

Gresa Muli, anëtare e KPF-së – tha se e di që ligji parasheh komision për secilën pronë, por për parcelën tek “Ura e Gurit” jemi ftuar si komision, por jo edhe për këtë parcelë që po flasim. Prandaj, kuvendi i komunës nuk është <circ>, por është organi më i lartë i komunës. Një vendim që merret, ose duhet të shkojë deri në fund ose të anulohet, e jo të vjen vendim mbi vendim.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – duhet të hiqet nga rendi i ditës pika tetë (8), pasi që është puro politike, pra për interesa politike. Jemi në fundit e mandatit, edhe pak po futemi në vitin zgjedhor dhe nuk është në rregull të sjellim këso propozime puro politike.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës – theksoi se kjo pikë nuk është politike dhe nuk ka të bëjë me politikën. Qytetet e Kosovës duhet t'i ndërtojnë sheshet e pavarësisë, sepse jemi shtet, sikurse sheshet e dëshmorëve.

Vushtrria ka mungesë të hapësirave publike dhe vizioni jonë është që të kemi sa më shumë hapësira publike, në mënyrë që ta ngrisim kualitetin e qytetarëve të Vushtrrisë.

Objekti i ish-gjykatës është menduar të jepet në shfrytëzim, prandaj edhe është sjellë këtu. Për dy vite nuk kemi pasur asnjë interesim për atë objekt.

Nëse është pengesë emri <Ibrahim Rugova>, ulemi dhe bisedojmë, e quajmë vetëm “Sheshi i Pavarësisë”. Nuk e kem problem edhe ta shtyjmë për ndonjë seancë tjetër, por qëllimi është që të shfrytëzohen hapësirat publike.

Gresa Muli, anëtare e KPF-së – pasi që jemi përkrahës të hapësirave publike, atëherë të veprojmë njëjtë. Disa herë e kam cekur rastin të rruga në drejtim të çerdhes publike, të lokali “Casa mia”, ku nuk është ndërmarrë asgjë.

Haki Maloku, nga sekretaria – deklaroi se në aspektin procedural, këtij vendimi mund t’i shtohet një nen, përmes të cilit do të shfuqizohej vendimi paraprak.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës – tha se ne jemi në bashkëqeverisje, ku secili e kryen pjesën e vet të punës, ku shpesh ndajmë mendime të ndryshme për çështje të ndryshme.

Unë konsideroj që duhet të ruhet objekti i ish – gjykatës, jo se ka ndonjë vlerë historike, por ka vlerë reale dhe mund të shfrytëzohet sipas vendimit që ka marrë kuvendi i komunës. Të bëhet thirrja publike dhe ta shohim se a kemi të interesuar.

Nuk jemi kundër emrit të Ibrahim Rugovës. Ai tha se kemi institucione komunale, siç janë shkollat, por edhe institucione tjera që mund të bëhet emërtimi i tyre. Jam ithtar i asaj që ta thërrasim edhe PDK-në si subjekti më i madh opozitar këtu në Vushtrri që të propozoj një emër për emërtim të një shkolle.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – theksoi se për shkak të gjendjes me Covid, kërkoj që të mbështeten pikat shtesë. Pikën tetë (8): “Shqyrtimi i Propozim – vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Sheshit të Pavarësisë “Ibrahim Rugova” s’po e shoh të arsyeshme që të hiqet nga rendi i ditës, mund ta diskutojmë.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës – deklaroi se pikën 8 mund ta shqyrtojmë edhe në mbledhjen e ardhshme, nuk e kam asnjë problem. Prandaj, po e tërheqim nga kjo mbledhje dhe po e shtyjmë për mbledhjen e radhës.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri votoi që të hiqet nga rendi i ditës dhe të shqyrtohet në mbledhjen e radhës.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 15 tetor 2020;
2. Shqyrtimi i Draft – statutit për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të teatrit të qytetit të Vushtrrisë;
3. Shqyrtimi i Draft – rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të komunës (**shqyrtimi i parë**);
4. Shqyrtimi i propozim – vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në Parkun Industrial në Lumadh;
5. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndryshim dhe plotësim të vendimit 01 nr. 357/19, dt. 26.12.2019;

6. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndryshim dhe plotësim të vendimit 01 nr. 57/18, dt. 22.02.2018;
7. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për emërim të komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të shkollave në Komunën e Vushtrrisë;
8. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Kryqit të Kuq – dega në Vushtri;
9. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e Planit zhvillimor komunal;
10. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 15 tetor 2020.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 15 tetor 2020.

2. Shqyrtimi i Draft – statutit për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të teatrit të qytetit të Vushtrrisë.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – tha se përveç dy propozimeve tjera, në emër të grupit kuvendar propozoj që të jetë emërtimi “Teatri i qytetit”.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – edhe për këtë pikë kam thënë që është politike, prandaj propozimi i kolegut që të mbetet emërtimi “Teatri i Qytetit” është edhe propozim i imi.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës – u shpreh se kjo pikë le të shkojë në kuvend dhe të votohet për propozimet.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, anëtarët e KPF-së njëzëri u pajtuan që tri propozime të dërgohen në kuvend për votim: “Adem Mikullovi, “Xhemail Cecelia”, “Teatri i Qytetit”.

3. Shqyrtimi i Draft – rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të komunës (**shqyrtimi i parë**).

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

4. Shqyrtimi i propozim – vendimit paraparak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në Parkun Industrial në Lumadh.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – tha se punimet në parkun industrial janë në përfundim. Por, po e paraqes si shqetësim çështjen e kanalizimit të lagjes “Bregaj”, që janë 5 apo 6 familje që janë afër aty. A ekziston mundësia ligjore që të kyçen në rrjetin e kanalizimit të parkut industrial?

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – deklaroi se këtu kemi dy certifikata të pronësisë 13 hektar dhe 6 hektar. Sa e di unë kanë qenë mbi 14 hektarë. Nëse ka mundësi të rregullohet kopja e planit dhe të bëhet ndarja (kufizimi) i parcelave që jepen në shfrytëzim.

Adnan Lahu, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – tha se ky propozim-vendim është përgatitur nga zyra e kryetarit dhe informatat që i kanë kërkuar ua kemi sjell. Por, për kuvend do ta përmirësojmë, tha ai.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës – tha se zonat ekonomike janë të mbrojtura me ligj dhe nuk ka mundësi ligjore të kyçen në rrjetin e kanalizimit dikush tjetër.

Tahiri deklaroi se duhet të caktohet edhe çmimi për metër katror dhe duhet të përmirësohet në propozim që është çmimi për ari.

Tahiri deklaroi se bashkë me nënkryetarin kemi pasur disa takime me investitorë të huaj dhe investitorë nga diaspora dhe ekziston një interesim i jashtëzakonshëm.

Po ashtu, në konkurs t'iu kërkohej bizneseve edhe garancionin bankar si kusht për realizimin e investimeve.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – deklaroi se unë personalisht mendoj që tri vitet e para bizneset mos të paguajnë fare kompensim.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës – theksoi se kjo zonë ka me qenë një nga zonat më atraktive dhe ka me pasë konkurrencë të madhe. Ndoshta është mirë të kushtëzohen se ata që aplikojnë në konkursin e parë ta kenë mundësinë që tri vitet e para mos të paguajnë kompensim.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – tha se bizneset që vendosen afër magjistrales do të kenë një prioritet. A do jetë çmimi i njëjtë si për ata që janë afër magjistrales, si për ata që gjenden në një hapësirë më larg?

A do të ketë kriter për vendosje se cilat biznese do të vendosen afër magjistrales e cilat më në brendësi?

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës – deklaroi se në hyrje të zonës do të vendosen reklamat e secilit biznes. Por, për vendosje në hapësirë do të vendos komisioni.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

5. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndryshim dhe plotësim të vendimit 01 nr. 357/19, dt. 26.12.2019.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

6. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndryshim dhe plotësim të vendimit 01 nr. 57/18, dt. 22.02.2018.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

7. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për emërim të komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të shkollave në Komunën e Vushtrrisë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – nëse ka mundësi që deri në mbledhjen e kuvendit të na vjen edhe emri i anëtarit të komisionit nga MASHT-i.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha se pasi që emrat e anëtarëve të komisionit janë të njëjtë, nëse ekziston mundësia të bëhet vetëm një propozim-vendim.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

8. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Kryqit të Kuq – dega në Vushtri.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – më herët bisedova edhe me drejtori, sepse ekziston një mangësi në këtë propozim, por drejtori u zotua se do të përmirësohet për kuvend.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

9. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e Planit zhvillimor komunal.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – pyeti se për cilin plan zhvillimor komunal është hartuar kjo informatë? Pasi që është thënë se kanë qenë dy versione të planit zhvillimor.

Berat Sadiku, drejtor i Drejtorisë Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – deklaroi se informata ka të bëjë me zbatimin e planit zhvillimor komunal 2016 – 2024 që është votuar në kuvendin komunal.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

10. Shqyrtimi i Draft – Strategjisë Zhvillimore të Komunës për vitet 2020 - 2025 (shqyrtimi i parë).

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

11. Shqyrtimi i Draft – Strategjisë Zhvillimore të Komunës për vitet 2020 - 2025 (shqyrtimi i parë).

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha se ekzistojnë disa gabime tek shkurtesat, diku shqip e diku anglisht. Mirë do të ishte ose të vendosen shkurtesat të gjitha shqip ose anglisht.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

12. Shqyrtimi i propozim – vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

12. Shqyrtimi i propozim – vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

13. Shqyrtimi i propozim – vendimit për formim të komisionit vlerësues për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës – tha se ky komision ka mundur të jetë edhe me 5 anëtarë, por me qëllim që të përfshihen grupet më të mëdha politike nga kuvendi e kemi sjellë propozimin që të jetë 7 anëtarë (3 nga kuvendi, 3 nga qeveria komunale dhe një nga shoqëria civile).

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me gjashtë vota “për” dhe një “abstenim” rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

14. Shqyrtimi i konkursit publik për vendosje në Parkun Industrial.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

15. Të ndryshme.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së- tha se bashkë me kryetaren e KVRL-së, Drita Dibrani kemi pasur një takim me qendrën rinore në Obiliq, ku u bisedua mundësia për hapjen e një kodi buxhetor për rini.


Drita Dibrani, kryetare e KVRL-së- theksoi se edhe më herët me kryetarin e komunës dhe me drejtorin e buxhetit kemi biseduar për mundësinë e hapjes së një kodi për rininë. Pra, ne po kërkojmë që ta kemi një kod buxhetor për zhvillimin e aktiviteteve. Ajo tha se kuvendi komunal të vendos që në vitin 2021 të ndahet një kod buxhetor për përkrahje të rinisë.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës – tha se në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa do ta shohim këtë mundësi.

Mbledhja përfundoi në orën **16:15**.

Bujar Klinaku

Bujar Klinaku
Procesmbajtës



Nasuf Aliu

Kryesues i KÇK-së dhe i KPF- së